



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga “MIGJENI” (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

OSHP. nr. 827/2024

Data e vendimit: 19.09.2024

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) “KAM Construction” Sh.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shtëpive të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara në Rahovec” me numër të prokurimit 623-24-6432-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Rahovecit. Ud.Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Agim Sheqiri me datën 19/09/2024, mori këtë:

VENDIM

I. Hedhet si e palejuar, ankesa e “KAM Construction” Sh.P.K.. me nr. të protokollit 2024/0827, e datës 09.09.2024, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shtëpive të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara në Rahovec” me numër të prokurimit 623-24-6432-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Rahovecit.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Rahovecit që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shtëpive të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara në Rahovec” me numër të prokurimit 623-24-6432-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 09.09.2024, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE “KAM Construction” Sh.P.K. për aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shtëpive të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara në Rahovec” me numër të prokurimit 623-24-6432-5-1-1, iniciuar nga Komuna e Rahovecit në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimi të ankesave pas pranimi të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka kryer pagesën siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së dhe nenin 69 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesën e lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, edhe pse zyra për pranimin e ankesave me datën 13.09.2024 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës se pas ekzaminimit të shkresave që i keni bashkangjitur ne platformë OSHP, ka konstatuar se nuk keni kryer pagesën siç parashihet ne paragrafin 2 te nenit 69 te rregullores 001/2022 te prokurimit publik. citojmë nenin 69.2 “Në përputhje me nenin 118 të LPP-së, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife të ankesave në OSHP. a. Kurdo që ankesa ndërlihet me vendimin për shpërbllim të një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) të vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5, 000 Euro”. andaj luteni që afatin e mbetur te na e përcjellin dëshminë lidhur me pagesën **në të kundërtën Ankesa do të refuzohet.** Për të cilën OE ankues “KAM Construction” Sh.P.K. lidhur me e-mailin e dërguar nuk ka kthyer përgjigje.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE “KAM Construction” Sh.P.K.. e datës 09.09.2024 (protokoll 0827/2024), për aktivitetin e prokurimit me titull “Renovimi i shtëpive të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara në Rahovec” me numër të prokurimit 623-24-6432-5-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Rahovecit konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si palejuar -jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Komuna e Rahovecit që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i shtëpive të komunitetit për personat me aftësi të kufizuara në Rahovec” me numër të prokurimit 623-24-6432-5-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni AK, se në çdo aktivitet

duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60 të LPP-së.

Ud. Kryesuesi i OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Rahovecit

1x1 OE. "KAM Construction" Sh.P.K

1x1 Arhivës së OSHP-së;

Agim Sheqiri
Ud. Kryesues i Sekretariatit të OSHP-së

